REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE MBROJTJES SE TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr._____ Prot **Bilisht më : __/___/2025**

PROJEKT-VENDIM

NR 23 DATE 21 / 03 /2025

"DETAJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nenpika 1.1 shkronja b, neni 29, Ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" I ndryshuar, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor të Republikës së Shqipërisë" I ndryshuar, Ligjin Nr. 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025, Ligjit Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 30, VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave të ndarjes dhe perdorimit të fondeve të kushtëzuara të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile" I ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Shkresës Nr. 492/1 prot datë 25.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"

PROPOZOJ:

1. Te miratoje detajimin dhe perdorimin e fondit te kushtezuar per Mbrojtjen Civile te vleres **5,600,263.52** lekesh si me poshte:

TABELA PER SHPENZIMET E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE **BASHKIA DEVOLL**					
Nr	**Zerat e shpenzimeve te buxhetit per fondin e kushtezuar te Mbrojtjes Civile**	**Shuma e planifikuar**	**% ndaj buxhetit total**	**Shuma e shpenzimeve faktike**	**Shuma e mbetur**

1	**Ndihme financiare per familjet e demtuara**	**500,000**	**8.93%**		
2	**Blerje te materialeve te ndryshme qe i sherbejne veprimtarise te strukturave te emergjencave civile**	**5,100,263.52**	**91.07%**		

2. Për zbatimin e tij ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe Buxhetit dhe sektori i Emergjencave Civile.
3. Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Br. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar.

Konceptoi:**Y.Stena**

Konfirmoi bazën ligjore:**E.Avdo**

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE MBROJTJES SE TERRITORIT

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1068 **Prot** **Bilisht më :** 4/03/**2025**

RELACION

PËR PROJEKT VENDIMIN "DETAJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR PER MBROJTJEN CIVILE"

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bazuar në ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe nenit 15 të ligjit 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025 ka akorduar fondin në programin e "Emergjencat Civile" të Ministrisë të Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka përllogaritur vlerën prej 5,600,263.52 lekë për Bashkinë Devoll.

Përsa më sipër Sektori i Emergjencave Civile ka përgatitur tabelën për shpenzimet e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile për vitin 2025, në të cilën kemi përfshirë 2 zerat e shpenzimeve të buxhetit për fondin e kushtëzuar.

Në zërin e parë bën pjesë "ndihma financiare për familjet e dëmtuara" ku shuma e planifikuar për këtë zë është në vlerën 500,000 lekë ose 8.93% e Buxhetit total për vitin 2025 për Mbrojtjen Civile dhe është menduar që vlera e kompensimit të jetë në lekë për familjet e dëmtuara.

Në zërin e dytë bën pjesë "blerja e materialeve të ndryshme që i shërbejnë veprimtarisë të strukturave të emergjencave civile" ku shuma e planifikuar për këtë zë është në vlerën 5,100,263.52 lekë ose 91.07% e Buxhetit total për vitin 2025 për Mbrojtjen Civile dhe është menduar që ky fond të shpenzohet për blerjen e një automjeti që do të shërbejë për plotësimin e e nevojave të sektorit të Emergjencave Civile për ti ardhur në ndihmë të komunitetit.

Konceptoi: **Y.Stena**

Pranoi: **M.Mulla**

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.al/

Nr. 013 Prot
Dt. 27.02.2025

Selci Emiljo
Kryetar Bashkie

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

Nr. 492/1 prot. Tiranë, më 25.02.2025

Statusi: **Urgjent**

Lënda: Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

BASHKIA DEVOLL

Devoll

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bazuar ligjit 45/ 2019, "Për mbrojtjen civile", përkatësisht kreu II, neni 8, shkronja ç, kreu II, neni 23, shkronja d dhe nenit 15 të ligjit 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale, ju informon se:

Fondi i akorduar, në programin "Emergjecat civile" të Ministrisë së Mbrojtjes i cili do të shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila me anë të shkresës nr. 2126/1 prot., datë 19.02.2025 "Dërgohen buxhetet e bashkive për vitin 2025" e ka përllogaritur për bashkinë tuaj peshën specifike në masën 0.70% me vlerë 5,600,263.52 lekë.

Për vitin 2025 në degën e thesarit për Artikullin 604, janë funksional dy kode si më poshtë vijon:

1. Kodi i produktit 91707AG - "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve".
2. Kodi i produktit 91707AB - "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".

Për sa më sipër, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, kërkojmë nga ana juaj ndarjen e masës që do të përdoret sipas fondit në dispozicion.

Informacioni i kërkuar, duhet të përcillet brenda datës 28.02.2025, në rast të kundërt nuk do mund të realizohet alokimi i fondit. Për përcjelljen e informacionit brenda datës së kërkuar mund të përdorni edhe postën elektronike duke e dërguar në adresën bleona.goshi@akmc.gov.al.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Haki Çako